

Shorti për KED-në

Gramoz Ruçi – Fillojmë!

Të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Të nderuar përfaqësues të Trupit Diplomatik,

Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare,

Të nderuar deputetë,

Në zbatim të dispozitave të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas shkresës zyrtare nr. 3479, datë 23.11.2018 të Presidentit të Republikës, po zhvilloj sot procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).

Paraprakisht, po ju paraqes disa veprime të kryera nga Kuvendi i Shqipërisë para hedhjes së shortit. Në zbatim të pikës 3 të nenit 149, “d”, si dhe të nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Kryetari i Kuvendit ka nxjerrë urdhrin nr. 1 datë 03.12.2018 “Për caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, si dhe urdhrin nr. 2 “Për përcaktimin e procedurës dhe të rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, që janë publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Në zbatim të pikës 3 të urdhrit nr. 2 të Kryetarit të Kuvendit, sekretari i Përgjithshëm me urdhrin nr. 409, datë 05.12.2018, ka ngritur Sekretariatit Teknik, i cili do të organizojë dhe do të kryejë procedurat e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Kuvendit, paraprakisht, ka njoftuar zyrtarisht për datën dhe për orën e organizimit të shortit:

- Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetarin e Gjykatës së Lartë;
- Prokurorin e Përgjithshëm;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

- Avokatin e Popullit, i cili sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016, merr pjesë si vëzhgues, si dhe harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit;
- Kryetarin e Komisionit të Pavarur të Monitorimit.

Gjithashtu, në procedurën e hedhjes së shortit janë ftuar të marrin pjesë:

- Përfaqësuesit e grupeve parlamentare;
- Përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë;
- Organizatat ndërkombëtare;
- Mediet.

Në kuadër të transparencës, njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit së bashku me urdhrat nr. 2 dhe nr. 3, datë 03.12.2018 të Kryetarit të Kuvendit, janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Listat e kandidatëve që i plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji i janë përcjellë zyrtarisht Kuvendit nga institucionet përkatëse, si dhe janë bërë publike në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Fillojmë menjëherë me verifikimin e pranisë së përfaqësuesve të këtyre institucioneve.

Sekretariati Teknik ka verifikuar paraprakisht praninë e përfaqësuesve të institucioneve të sipërpërmendura.

U lutem përfaqësuesve të prezantohen!

Nga Gjykata Kushtetuese?

(Nuk dëgjohet)

Nga Gjykata e Lartë?

Miran Kopani – Miran Kopani.

Gramoz Ruçi - Nga Prokuroria e Përgjithshme?

Adnan Xholi - Adnan Xholi.

Gramoz Ruçi - Nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë?

Vildan Kaloshi - Vildan Kaloshi.

Gramoz Ruçi - Nga Avokati i Popullit?

Erinda Ballanca - Erinda Ballanca, e pranishme.

Gramoz Ruçi - Pra, rezulton se të gjithë përfaqësuesit e institucioneve janë të pranishëm.

Vijojmë më tej me procesin e hedhjes së shortit!

Sekretariati Teknik të fillojë procesin e përgatitjes së hedhjes së shortit sipas procedurave të përcaktuara në Rregullore dhe të miratuara me urdhrin nr. 2, datë 03.12.2018 të Kryetarit të Kuvendit.

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Duhet thënë që në fillim, se hedhja e shortit sot nga Kuvendi i Shqipërisë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Këtë e thotë në përgjigjen që ka sjellë Presidenti i Republikës, i cili thotë se është në pamundësi për të hedhur shortin për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për sa kohë mungon baza ligjore. Arsyeja është shumë e thjeshtë, sepse dispozitat e ligjit sot nuk ekzistojnë për hedhjen e këtij shorti. Po ashtu, Presidenti i Republikës e bën të qartë se është në pamundësi të hedhë një short, në kushtet kur dispozitat transitore kanë vdekur, e kanë kryer detyrën e tyre në vitin 2016, nëse doni ju edhe në periudhën dhjetor 2016 – janar 2017, por e kanë përmbyllur detyrën e tyre (dispozitat transitore me një qëllim specifik, me objekt specifik: një short në një kohë të caktuar dhe brenda një afati të caktuar).

Sigurisht, kur Kushtetuta hyri në fuqi në vitin 2016 nuk mund të pretendohet të kishim menjëherë organet e sistemit të drejtësisë të parashikuara nga neni 221 i ligjit “Për organet e sistemit të drejtësisë” dhe nga Kushtetuta, mbi të gjitha, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Sigurisht, në atë periudhë ishte e pamundur dhe për rrjedhojë neni 284 do të bënte punë. Por neni 284 ka kohë që e ka ezauruar detyrën e tij dhe për rrjedhojë nuk mund të shërbejë sot si bazë ligjore. Këtë e thotë Presidenti i Republikës, i cili i sugjeron parlamentit të Shqipërisë të ndërmarrë masat legislative për ta përmbyllur këtë boshllëk. Sigurisht, është e nevojshme ndërhyrja në një ligj me shumicë të cilësuar, por kjo nuk e autorizon parlamentin e Shqipërisë, dhe kjo është të paktën hera e dytë, që të uzurpojë kompetencën e Presidentit të Republikës dhe, mbi të gjitha, të shkelë Kushtetutën e ligjin: të veprojë pa asnjë bazë kushtetuese dhe ligjore për hedhjen e shortit për ngritjen e një organi, i cili do të vendosë bazat e funksionimit të dy organeve shumë të rëndësishme, të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Ju të gjithë e dini që në qoftë se dështon parlamenti apo cilido organ tjetër në zgjedhjen e këtyre funksioneve, e këtyre zyrtarëve të lartë, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, ai që do të kapë shortin, ajo forcë politike që do të dominojë shortin sot, ku dominimi është perceptim dhe perceptimet shpeshherë janë më të vërteta sesa realitetet, ato zyrtare, renditja i pari nga ajo KED do të jetë emërimi sot i këtyre organeve kushtetuese, pra i Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Është pikërisht arsyeja pse juve, si maxhorancë, nuk ju kanë pëlqyer shortet e hedhura në vitet 2017 dhe 2018, pra dy KED njëvjeçare të një organi të çuditshëm kushtetues, i cili që në fillimet e tij e kishte synimin vetëm të kapja e sistemit të drejtësisë, i reduktuar përsëri siç është, efektin e ka, ishte pikërisht shorti i papëlqyer prej jush që bllokoi dy herë funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, qoftë edhe i paligjshëm, siç ishte.

Të dyja herët, sidomos ajo në vitin 2017, nën një interpretim të asaj kohe të kreut të Komisionit të Ligjeve, në kundërshtim me Kushtetutën, bllokuat funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me pretendimin se pa u bërë vetingu, nuk mund të funksionojë, ndërkohë që Kushtetuta e thotë qartë se anëtarët, pra do të thotë se atyre që janë emëruar dhe janë në funksion u bëhet vetingu me përparësi. Por e përdorët këtë pikërisht për të penguar ngritjen e Gjykatës Kushtetuese dhe më pas Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Këtë do ta bëni vetëm atëherë kur shorti të jetë i favorshëm për ju. Kur e patë që nuk e zgjasnit dot shumë me këtë, në vitin 2018 e zbërthyet fije-fije Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, për rrjedhojë sot, ashtu si i gjithë sistemi, kemi 2 vjet e gjysmë pas reformës që nuk ngremë dot sistemin në drejtësi. Unë i bëj thirrje publikut vetëm të kujtojë se cila është ajo reformë që është quajtur e suksesshme kur në 2 vjet e gjysmë ende nuk ka arritur të ngrejë një institucion.

Zoti Kryetar, e përsëris Presidenti i Republikës jua ka bërë shumë të qartë dhe ju ka thënë: “Unë dua ta ushtroj, por nuk kam mundësi, sepse nuk kam bazë ligjore”. Kjo nuk ju jep juve mundësi, sepse ju nuk keni mbledhur as Këshillin e Legjislacionit, të bëni një interpretim të kësaj çështjeje që ngre Presidenti i Republikës, pra nuk ju jep mundësinë që, pa një bazë ligjore, të bëni shortin sot, sepse produkti i këtij shorti është i paligjshëm, mbi të gjitha, është edhe antikushtetues.

Tani të themi pasojat e kësaj dispozite transitorë që t'i kuptojnë shqiptarët, por të kuptojnë edhe çfarë ndodh me procesin, sepse ndoshta kanë parë gjëra që nuk i lidhin dot, i çudisin, por nuk i lidhin dot bashkë. Neni 284 për periudhën transitorë (po ky tranzicioni juaj, për shembull në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm zgjat një vit, por edhe më shumë, për sistemin e drejtësisë është një tranzicion që nuk i shihet ende fundi), kjo dispozitë transitorë bën një derogim. Ia jep funksionin e përzgjedhjes dhe filtrimit të kandidaturave (por ato nuk janë kandidatura, sepse janë kandidatura të detyruara, të cilat jua sjellin juve këtu sot) ua jep katër personave dhe jo institucioneve. Kështu, kur thoni që po bëjmë verifikimin e institucioneve, në fakt duhet të bëni verifikimin e personave që parashikon ligji, sepse Kushtetuta dhe neni 221 i ligjit parashikojnë që kandidaturat të filtrohen, pra të verifikohen për përputhshmërinë e tyre me kriteret ligjore nga tri organe kolegjiale, nga Gjykata Kushtetuese, e cila sot është e vdekur praktikisht, nga KLGJ-ja dhe nga KLP-ja, dy organe që ende nuk kanë lindur, të cilat është e qartë pas pak ditësh do të lindin me defektet e tyre kushtuese, por sot nuk kanë lindur. Këto organe kushtetuese kanë detyrë të verifikojnë përputhshmërinë me kriteret ligjore të kandidaturave të lira nga sistemi gjyqësor që u shkojnë atyre për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Si rregull, do të ishte një organ prestigjioz, ku kushdo gjyqtar, qoftë edhe për një vit, megjithëse kjo më duket edhe qesharake, do të donte të ishte pjesë e këtij sistemi të drejtësisë. Ndërsa sot ju keni gjyqtarë dhe prokurorë që nuk guxojnë t'i afrohen Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, sepse vendosen në gijotinë me prioritet, nëse juve nuk pëlqen shorti. Pra, një proces që do të shkonte me kandidatura të lira profesionistësh dhe që do të filtrohej nga organe kolegjiale, ku kolegjaliteti do të ishte garanci për një balancë në gjykimin e këtyre organeve ju e keni zëvendësuar me një dispozitë. Në fazë transitorë edhe mund të përtypet. E keni zëvendësuar me katër personave, që nuk janë organe monokratike, me kreun e Gjykatës së Lartë, me kreun e Gjykatës Kushtetuese me Prokurorin e Përgjithshëm të përkohshëm, për fatin tonë të keq, ku për pak ditë do t'i urojmë 1 vjetorin lindjes së kësaj krijese të çuditshme në sistemin kushtetues shqiptar, dhe një nëpunësi civil, siç është sekretari i Përgjithshëm i KLD,-së, organ i cili është në grahmat e fundit të ekzistencës së tij kushtetuese. Por të bëjmë pak llogari, Prokurorin e Përgjithshëm të përkohshëm, ne e dimë të gjithë se kush është, i zgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën në mënyrë flagrante, i kapur pas një grimce në një nen që nuk ka kuptim, i cili as

vetëm nuk ka kuptim, jo më ta lexosh në tërësinë e ligjit, i votuar në kundërshtim me kërkesën kushtetuese për 3/5-at për votimin, por me 69 vota, më pak se shumica absolute prej 71 votash. Pra, një krijesë që është mbajtur gjallë pikërisht për të bërë këtë që po bëhet sot, për të dërguar një listë me emra për këtë short dhe për të thirrur mbledhjen tjetër në datën 11, pas pak ditësh, për këtë detyrë. Sigurisht, edhe për detyra të tjera, çështje dosjesh, transferimesh dhe shkarkimesh në kundërshtim me ligjin, por që nuk është objekt i këtij diskutimi sot.

Kemi kreun e Gjykatës Kushtetuese, i vetmi anëtar i Gjykatës Kushtetuese me mandat, që ka kaluar procesin e vetingut, por është nën drithërimat e përmbylljes së procesit të vetingut, sepse është i ankimuar dhe për rrjedhojë nuk dihet se çfarë ndodh në KPA-në e famshme. Kreu i Gjykatës së Lartë e ka kaluar vetingun, i ankimuar pret mëshirën e KPA-së. Pra, kemi dy zyrtarë, më të lartët në sistemin tonë të drejtësisë, të cilët presin me ankth se çfarë do të ndodhë me ta, ndërkohë duhet të firmosin një listë për ju këtu. Këtë ne duhet ta nënkuptojmë si një proces me vullnet të lirë. Pra, ndryshe nga Gjykata Kushtetuese, KLGJ-ja dhe KLP-ja, ku ata prisnin kandidaturat dhe shihnin nëse këta përputheshin me ligjin, këta përzgjedhin dhe janë këta që vendosin se cila është lista që do t'ju sjellin juve këtu dhe, nëse nuk ju pëlqen shortin, siç keni bërë dy herë rresht, më pas është vetingu. Tre i nxorëm, nëpunësi civil mbyll detyrën e tij në ditën kur ngrihet Këshilli i Lartë Gjyqësor, pra kemi katër persona, jo institucione, të cilët, në kundërshtim me atë që është dispozita normale, për sa kohë do t'ju duhet juve, edhe nëse këtë vit nuk do t'ju pëlqejë shorti, këtë histori do ta dëgjoni edhe në fundin e viti 2019, sepse objektivi është shumë i qartë, kapja politike e sistemit të drejtësisë.

Dua t'ju kujtoj diçka. Kur është hedhur shorti i parë tranzitor, ishin vetëm tri pozicione vakante në Gjykatën Kushtetuese, por në logjikën normale do të ishte pjesë e asaj që Kushtetuta dhe reforma në drejtësi vendosi që Gjykata Kushtetuese të qëndronte e paprekur dhe të vazhdonte detyrën e saj, edhe pse iu lidh dora që të mos shqyrtonte, në aspektin principial kushtetues, dispozitat e reja kushtetuese. Kjo ishte gjë e padëgjuar, e bëmë ne, por ishin vetë 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, sot janë 8 dhe, praktikisht, nëse ju nuk vendosni sot me KPA-në që të largoni edhe kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të bëhen 9, ju keni të gjithë gjykimin e Gjykatës Kushtetuese që, nëpërmjet një KED-je të kapur prej jush, në mënyrë të paligjshme, të përcaktoni (jo nuk ka rëndësi kush është i dyti apo i shtati në listën e kandidatëve) se kush është i

pari (kolegu im buzëqesh, sepse e kupton këtë gjë), do të jetë anëtari i ri i Gjykatës Kushtetuese, sigurish, në qoftë se heq dorë edhe Presidenti i Republikës për shkak të paligjshmërisë që po ndodh sot këtu. Për 9 vjetët e ardhshëm ata do të jenë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, për 9 vjetët e ardhshëm do të merrni vulën mbi ligjet tuaja që kalojnë, që sot nuk i kaloni dot.

Po kështu inspektori i Lartë i Drejtësisë do të jetë ai që do të bëjë atë që ka nevojë maxhoranca në disiplinimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve për t'i çuar te KLGJ-ja dhe KLP-ja, ku 5 anëtarët laikë të secilës trup i keni kapur me shortin e turpshëm të fillimit të vitit, dhe do të zgjidhni 6 gjyqtarët dhe prokurorët që, nëpërmjet një procesi vetingu, i keni filtruar te numri minimal i domosdoshëm që ju duhet juve dhe emrat mundësisht specifike që ju duhen për të kompletuar jo 5+1, për të bërë 6 vota, por mundësisht 11 anëtarët të vendosin siç kërkoni ju, për të ngritur sistemin e ri të drejtësisë, për të emëruar dhe për të shkarkuar gjyqtarët. Ky është thelbi pse sot një dispozitë transitore vlen sa e gjithë Kushtetuta, nxjerr nga binarët të gjithë Kushtetutën, nxjerr nga binarët të gjithë sistemin e drejtësisë dhe vendos sistemin e drejtësisë në binarët që doni ju për 5, 7 apo 9 vjetët e ardhshëm. Prandaj thirrja ime: është tërhiquni nga ky short sot, pranoni kërkesën që ju bën Presidenti i Republikës, plotësoni boshllëkun ligjor që KED-ja të nisë funksionimin në mënyrë kushtetuese dhe më pas të kemi shansin që të paktën copëra nga sistemi i drejtësisë të jenë ashtu siç i ka parashikuar reforma konsensuale e 22 korrikut 2016.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Dy gjëra të shkurtra, sepse sot këtu nuk jemi mbledhur për të debatuar, por për të hedhur shortin.

Meqenëse artikullohet letra e Presidentit, dërguar Kryetarit të Kuvendit, unë e lexova me shumë vëmendje, por jo vetëm kaq, me shumë përgjegjësi jam konsultuar lidhur me pretendimet e ngritura në këtë letër me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; u konsultova shumë imtësisht me ligjin organik, që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë, u konsultova me Drejtorinë Juridike të Kuvendit, me Komisionin e Ligjeve dhe Këshillin e Legjislacionit të Kuvendit, nëpërmjet tyre me dy organizmat, EURALIUS-in dhe OPDAT-in, që monitorojnë nga afër

çështjet dhe, pasi bëra të gjithë këtë proces, kam arritur në përfundimin që kam nxjerrë ato dy urdhra, të cilat i parashtrova.

Sot këtu nuk është as koha, as vendi dhe as institucioni ku mund të parashtrohen dhe të diskutohen këto urdhra, sot është vendi ku hidhet shorti.

U lutem të gjithë të pranishmëve këtu jemi, që, në mbështetje të ligjit, të bëjnë çdo ndërhyrje për sa u përket procedurave të shortit. Nuk është vendi për asnjë debat tjetër, prandaj po vazhdoj me shortin për anëtar të KED-së nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Nga lista që është dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.398, datë 15.11.2018, rezulton se janë dy kandidatë për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas nenit 149, pika “d” të Kushtetutës, neni 220 të ligjit 115/2016 “Për Këshillin e Emërimeve të Drejtësisë” nga Gjykata Kushtetuese zgjidhen 2 anëtar të përhershëm dhe 1 anëtar zëvendësues.

Për sa më sipër, konstatojmë se procedura e shortit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të KED-së nga Gjykata Kushtetuese nuk mund të zhvillohet, pasi për 2 vende vakante ka vetëm 2 kandidatura, që në këtë rast konsiderohen automatikisht anëtar të zgjedhur të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pra, anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese rezultojnë dy kandidatët e propozuar, zonja Vitore Tusha dhe zoti Bashkim Dedja.

Për shkak të mungesës së kandidaturave, njëherësh, nuk mund të zhvillohet shorti për anëtarin zëvendësues nga Gjykata Kushtetuese.

Shorti për anëtar të KED-së nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Nga lista që është dërguar nga Gjykata e Lartë, me shkresën 3982, datë 13.11.2018, rezulton se janë 3 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas nenit 149, pika “d” të Kushtetutës, neni 220 të ligjit 115/2016 “Për Këshillin e Emërimeve të Drejtësisë” nga Gjykata e Lartë zgjidhet 1 anëtar i përhershëm dhe 1 anëtar zëvendësues.

Fillojmë menjëherë me shortin për përzgjedhjen e anëtarëve nga lista e kandidatëve të përcjellë nga ky institucion. Ftoj sekretarinë të fillojë nga procedura.

Ju lutem, të lexohen emrat e kandidatëve, të futen në gogël dhe pastaj të hidhet shorti!

Lexoni emrin!

(Sekretariati Teknik lexon emrat e listës.)

Edmond Islamaj

Medi Bici

Ardian Dvorani.

(Sekretariati teknik, pasi përzgjedhi goglen lexon emrin.)

Ardian Dvorani.

Gramoz Ruçi – Pra, sipas shortit, anëtar nga Gjykata e Lartë është zoti Ardian Dvorani.

Vazhdojmë me tërheqjen e gogles së dytë, që është për anëtarin zëvendësues që është nga Gjykata e Lartë.

(Sekretariati teknik lexon emrin.)

Mehdi Bici.

Gramoz Ruçi –Vazhdojmë shortin për anëtarin e KED-së nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën zyrtare nr. 3054, datë 14.11.2018 drejtuar Kuvendit ka paraqitur vetëm një kandidaturë nga Prokuroria e Përgjithshme që i plotëson kushtet ligjore. Sipas ligjit në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi zgjidhet një anëtar i përherëshëm nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe një anëtar zëvendësues. Në këto kushte konstatojmë se procedura e shortit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit që i përket kësaj kategorie, nuk mund të zhvillohet pasi ka vetëm një kandidaturë të propozuar, në këtë rast kandidati do të konsiderohet automatikisht anëtar i zgjedhur i Këshillit. Pra, anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton kandidatja e vetme e propozuar, zonja Arta Marku. Për shkak të mungesës së kandidaturave të tjera nuk mund të zhvillohet shorti për anëtarin zëvendësues nga Prokuroria e Përgjithshme.

Vazhdojmë me shortin për anëtar të KED-së nga prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të Apelit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Erinda Ballanca - Nëse mundem, kam një pyetje për sekretariatit. Kjo është një çështje që ka goxha rëndësi, pasi ne e kemi verifikuar edhe në raportin e monitorimit që kemi paraqitur

vitin e kaluar. Kriteret e përdorura nga ana e institucioneve që kanë dërguar listat janë të ndryshme për organe të ndryshme. Nëse ka një kriter për të dërguar nga Gjykata e Lartë vetëm 3 anëtarë, në fakt janë 4 dhe duke qenë se ka një kriter me të cilin është përjashtuar nga lista zoti Xhezair Zaganjori, ky kriter, për të cilin është bërë ky përjashtim nuk është zbatuar nga organet e tjera. Ka të bëjë me faktin nëse janë apo jo 10 vjet magistratë dhe çfarë do të thotë magistratë apo janë apo jo 10 vjet gjyqtarë. Janë çështje që kanë të bëjnë me kriterin, sepse ulet kuorumi, numri i personave që duhet të përfshihen në short. Kjo nuk është një gjë e parëndësishme, sepse duke ulur numrin e personave që përshihen, ndoshta shorti bëhet i pamundur dhe ikën edhe qëllimi i parashikuar në Kushtetutë, që duhet të bëhet me short, pra, qëllimi i ligjit dhe i legjislatorit që të mos jetë i përcaktuar apo i paracaktuar, por duhet të jetë i shortuar.

Oerd Bylykbashi- Zoti Kryetar, për procedurë?

Gramoz Ruçi – Po, ju lutem!

Oerd Bylykbashi – Pra, sigurisht që ju bini ndesh me një praktikë që e kontestuat dikur në lidhje me rastin kur ka më pak kandidatura, ose kandidatura është një e vetme, dikur e keni kontestuar, tani e pranoni, por ky është problemi juaj.

Në rastin e Prokurores së Përgjithshme të përkohshme, ta theksojmë, Arta Marku është prokurore, në fakt e caktuar në atë detyrë, por nuk është prokurore e Prokurorisë së Përgjithshme, është prokurore rrethi dhe për shkak të kësaj benevolencës suaj për ta mbajtur në detyrë deri më sot, vendos veten e vet në këtë listë.

Gjithashtu, kini parasysh se anëtari që u zgjodh nga Gjykata e Lartë, por edhe zëvendësuesi, janë që të dy kandidatë për Gjykatën Kushtetuese dhe pikërisht me kandidaturat e tyre do të rivlerësojnë veten. E mos harroni: nuk është votim KED-ja. KED-ja nuk ka votim. Nuk është organ kolegjal që voton, por rendit, që do të thotë se pika që i jep secili vlen. Nëse pika është minus, do të thotë se ka një problem në mekanizëm. Pra, të gjithë anëtarët duhet të jenë prezentë kur votojnë, pa qenë në konflikt interesi. Nuk është organ kolegjal vendimmarrës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, por këto janë të rëndësishme. Po flasim për Kushtetutën, s'po flasim për kumbulla.

Pra, dy anëtarë në konflikt interesi. Njëri i atakuar dhe i anatemuar, e për të cilin ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, e që duhej ta kishte lënë mandatin këtu e dy vite të shkuara, sepse ka qenë dy vjet në kundërshtim me mandatin e tij në Gjykatën e Lartë, pretendon të shkojë te ajo Gjykatë, e cila ka një vendim për të, nominalisht, dhe shkon të vlerësojë edhe veten e vet. Është tallje që ju e pranoni këtu, por sigurisht që edhe kjo është produkt i paligjshmërisë. Mbajeni shënim këtë!

Gramoz Ruçi – Zotëri, edhe një herë po ju them: këtu jemi në momentin e hedhjes së shortit dhe nuk kemi të drejtë të bëjmë komente apo të nxjerrim konkluzione për çështje. Sigurisht, po e nisim me Avokaten e Popullit, e cila është në rolin e vëzhgueses dhe ka të drejtë ta monitorojë dhe ta pasqyrojë këtë proces në një raport të vetin, por nuk mund të bëjmë objekt diskutimi asnjë pretendim që hidhet këtu.

Atëherë vazhdojmë me shortin e anëtarëve të KED-së, prokurorët e prokurorive pranë Gjykatave të Apelit.

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën zyrtare nr. 3054, datë 14, 11, 2018, drejtuar Kuvendit, ka paraqitur kandidaturë për prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit. Në këto kushte, duke qenë se ligji parashikon që në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi të zgjidhen dy anëtarë nga prokurorët pranë gjykatave të apelit, procedura e shortit për zgjedhjen e dy anëtarëve nuk mund të zhvillohet, pasi ka vetëm një kandidaturë. Kjo konsiderohet automatikisht anëtare e zgjedhur e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pra, anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, rezulton prokurorja Fatjona Memçaj.

Për shkak të mungesës së kandidaturave të tjera, nuk mund të zhvillohet shorti për anëtarin zëvendësues nga prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit.

Vazhdojmë me shortin e anëtarëve të KED-së nga gjyqtarët e gjykatave të apelit.

Nga lista që është dërguar prej Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. 3241/ 1, datë 04, 12. 2018, rezulton se nga gjykatat e apelit janë plot 14 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas nenit 149/”d” të Kushtetutës dhe nenit 220 të ligjit 115/ 2016, nga gjyqtarët e gjykatave të apelit zgjidhen dy anëtarë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si dhe një anëtar zëvendësues.

Fillojmë me shortin për përzgjedhjen e dy anëtarëve të përhershëm nga lista e kandidatëve për këtë kategori. Ftoj sekretarinë, që të fillojë procedura.

(Sekretariati teknik lexon emrat.)

Fatri Islamaj, Artur Kalaja, Desart Avdulaj, Enton Dhimitri, Olsi Xhavella, Aleks Nikolli, Brikena Ukperaj (Lubonja), Klodiana Gjyzari, Margarita Buhali, Albana Boksi, Gurali Braimllari, Edlira Petri, Elbana Lluri, Andi Civici.

(Sekretariati teknik tërheq goglën e pare dhe lexon emrin.)

Fatri Islamaj,

(Sekretariati teknik tërheq goglën e dytë dhe lexon emrin.)

Margarita Buhali.

Gramoz Ruçi – Të tërhiqet gogla e tretë, që është për anëtarët zëvendësues.

(Sekretariati teknik tërheq goglën e tretë dhe lexon emrin.)

Gurali Brahimllari.

Gramoz Ruçi – Vazhdojmë me shortin për anëtarët e KED-së, për gjyqtarët e gjykatave administrative.

Nga lista që është dërguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 3247/1, datë 14.12.2018, rezulton se nga Gjykata Administrative janë 16 kandidatë për anëtarë në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Sipas nenit 149/d të Kushtetutës dhe nenit 220 të ligjit nr. 115/2016, nga gjyqtarët e gjykatave administrative zgjidhet një anëtar në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si dhe një zëvendësues.

Fillojmë me shortin për të zgjedhur një anëtar të përhershëm nga lista e kandidatëve.

(Sekretariati teknik lexon emrat.)

Blerona Hasa, Altina Nasufi, Blerina Kondi, Fjoralba Prifti, Artur Malaj, Nafije Curri Hasko, Kastriot Selita, Gentiana Qeseja Muça, Amarildo Laçi, Rilinda Selimi, Klodiana Veizi Mema, Elda Vrioni, Erarbër Madhi, Eriol Roshi, Gentian Hamiti, Gentian Medja,

(Sekretariati teknik tërheq gojlën e parë dhe lexon emrin.)

Eriol Roshi.

Gramoz Ruçi – Për anëtar të përhershëm nga gjyqtarët e gjykatave administrative është

Eriol Roshi.

Vazhdojmë me tërheqjen e gojlës së dytë, që është për anëtarin zëvendësues.

(Sekretariati teknik tërheq gojlën e dytë dhe lexon emrin.)

Klodiana Veizi Mema.

Gramoz Ruçi – Këta ishin të Gjykatës Administrative.

Atëherë, shpallim rezultatin.

Në përfundim të hedhjes së shortit emrat e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të Përkohshëm janë:

nga Gjykata Kushtetuese, Vitore Tusha dhe Bashkim Dedja;

nga Gjykata e Lartë, Ardian Dvorani;

nga Prokuroria e Përgjithshme, Arta Marku;

nga Gjykata e Apelit, Fatri Islamaj;

nga Gjykata e Apelit, Margarita Buhali;

nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit, Fatjona Memçaj;

nga zyra e prokurorisë pranë gjykatave të apelit nuk ka kandidatë;

nga Gjykata Administrative, Eriol Roshi.

Anëtarët zëvendësues janë:

nga Gjykata Kushtetuese nuk ka anëtarë zëvendësues;

nga Gjykata e Lartë, Mehdi Beci;

nga Prokuroria e Përgjithshme nuk ka anëtar zëvendësues;

nga prokurorët në zyrat prokurorisë pranë gjykatave të apelit nuk ka anëtar zëvendësues;

nga gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gurali Brahimllari;

nga gjyqtarët e gjykatave administrative, Klodiana Veizi (Mema.)

Ju uroj suksese anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2019. Procesi mbyllet këtu.

Ju rikujtoj medieve se rezultatet e shortit së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit do të bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Mbledhja mbyllet këtu.